



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

VLORE

ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS

Nr. 82/28 Prot.

Datë: 09.01.2020

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 09.01.2020

VENDIM

Nr. 28, datë 9.01.2020

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
"BACHELOR" NË "BIOLOGJI"**

Mbështetur në shkronjën d të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën dh të pikës 1 në nenin 19 në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Biologji" (bashkëlidhur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE E PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE
BACHELOR NË BIOLOGJI

Vlorë, Maj 2019



Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015. "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit Të Lartë në Republikën Shqipërisë" dhe Statutin e Rregullores së Universitetit 'Ismael Qemali' të Vlorës dhe mbështetur në "to".

Kreu I: Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

Departamenti i Biologjisë është një nga Departamentet më të rinj të Universitetit "Ismael Qemali". I hapur në kuadrin e Fakultetit të Shkencave Teknike në vitin akademik 2010 -2011, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 124 datë 17.02. 2010 ai synon të ofrojë një formim të shkëlqyer akademik për të përgatitur profesionistët e ardhshëm të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin rajonal dhe kombëtar të vendit. Programi mësimor Bachelor në Biologji është program i ciklit të parë të studimeve, i ofruar nga Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave Teknike në Universitetin 'Ismael Qemali' Vlorë, dhe është i organizuar në tre vite akademike (6 semestra) dhe në përfundim të tij studentët grumbullojnë 180 ECTS dhe marrin diplomën: Bcs në Biologji.

Neni 2

Objektivat formuese të programit të studimit Bcs në Biologji

Përmes bashkëpunimit me njësi të tjera të Universitetit tonë, organizata të ndryshme, Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, në synojmë të përgatim biologë, mësues biologjie dhe specialistë të mjedisit e turizmit me aftësi akademike, sjellje dhe njohuri të denja për të konkuruar me kërkesat e tregut të punës brenda dhe jashtë vendit.

Ne ofrojmë për studentët tanë:

➤ Ciliësi në mësimdhënie duke aplikuar forma bashkëkohore të mësimdhënies.

➤ Përgatitje të lartë profesionale

➤ Zhvillimin e aktiviteteve kërkimore shkencore.

➤ Pjesëmarrje dhe përfaqësim dinjitoz në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

➤ Një staf plotësisht të kualifikuar i cili prezantohet me:

➤ Artikuj Shkencorë të botuar

➤ Libra të botuar

➤ Konferenca kombëtare e ndërkombëtare

Prioritet i departamentit tonë gjatë programit të studimit Bachelor në Biologji, është jo vetëm pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme shkencore në fushën e Biologjisë, por edhe hedhja e themeleve për të përgatitur specialistë të shumë fushave të tjera mbas këtij programi studimi sidomos në ato mjedisore, bioshëndetësore, në mësuesi si dhe specialistë të mirëfilltë të florës dhe të faunës.

- ☒ Kontributi në mënyrë efektive në formimin dhe zbatimin e politikave arsimore dhe vizionin e Universitetit të Vlorës, miratimin e rregullores të Universitetit dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë, duke reflektuar praktikën me të suksesshme kombëtare e ndërkombëtare.
- ☒ Kontributi në formimin dhe miratimin e politikave dhe rregullave përkatëse për krijimin e rolit të institucioneve akademike, duke përfshirë këtu pëmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi në fushat që departamenti mbulon.
- ☒ Përpunimi i planeve mësimore (kurrikulat) sipas kërkesave të Deklaratës së Bolonjës dhe orientimi i programeve mësimore drejt Institucioneve homologë perëndimorë
- ☒ Kualifikimi i stafit akademik nëpërmjet specializimeve pasuniversitare dhe marrjes së titujve dhe gradave shkencore
- ☒ Përmirësimi i materialeve didaktike në shërbim të mësimdhënies
- ☒ Zhvillimi i laboratoreve mësimorë në nivelet bashkëkohore të mësimdhënies
- ☒ Lidhja me organizatat dhe institucione të tjera që kanë qëllime të përafërta apo që ndihmojnë rehabilitimin e politikave rajonale arsimore, mjedisore, etj.
- ☒ Zgjerimi i informacionit mbi departamentin dhe marktin e tij në zona të tjera të Shqipërisë.
- ☒ Forcimi i procedurave të pranimit të kandidatëve të rinj në stafin akademik të mësimdhënies, përmes kritereve të qarta të testimit.
- ☒ Përfshirja e mendimit të studentëve për arritjen e objektivave të mësimdhënies
- ☒ Evidentimi i drejtimeve të reja të ekonomisë së tregut për Rajonin e Vlorës dhe më gjerë, zhvillimin e arsimit, problemet e mëdha mjedisore dhe menaxhimi i tyre.
- ☒ Përgatitja e biologëve të ardhshëm të aftë për tregun e punës: në prodhim, turizëm, ekspertë të mjedisit etj.
- ☒ Përgatitja e mësuesve të ardhshëm duke vërejtur nevojat e theksuara që ka në mjaft shkollë të rrethit të Vlorës, Fierit, Mallakastërës e Beratit për mësimdhënës në lëndën e biologjisë, të cilat aktualisht mbulohej nga personeli mësimor pa arsimin e duhur. Kështu vetëm në rrethin e Vlorës japin mësim rreth 40 mësues biologjie pa arsimin e duhur dhe 35 të tjerë dalin në pension në pesë vitet e ardhshme.



Programi i studimit Bachelor në Biologji zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Teknike të UV.

II. Pranimit kandidatëve

Neni 4

Programi i studimit Bachelor në Biologji realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave Teknike, UV dhe drejtohet nga Departamenti i Biologjisë si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 5

Pranimi i kandidatëve të rinj në programin e studimit Bachelor në Biologji bëhet sipas listave përkatëse të miratuara nga MASR.

Neni 6

Regjistrimet e studentëve në programin i studimit Bachelor në Biologji kryen nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Departamentit të Biologjisë në Fakultetin e Shkencave Teknike (FSHT).

Neni 7

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FSHT dhe UV.

Neni 8

Në programin e studimit Bachelor në Biologji kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UV, rregulloren mësimore të UV dhe rregulloren e brendshme të FSHT.

III. Organizimi i studimeve

Neni 9

Programi i studimit Bachelor në Biologji përfundon me marrjen e diplomës përkatëse "Bachelor në Biologji". Sasia e krediteve të grumbulluara nga studentët është 180 kredite. Diplomati që lëshohet në përfundim të programit të studimit shoqërohet me suplementin e diplomës.

Lista e disiplinave mësimore, të ndara në module dhe veprimtari të tjera formuese.



Lende te detyrueshme					
Disiplina e formimit te pergjithshem (32 kredite)	1	MAT 154	Kalkulus 1	8 kredite	
	2	FIZ 161	Fizike	8 kredite	
	3	KIM 143	Kimi e Pergjitheshme	8 kredite	
	4	KIM 255	Kimi Organike	8 kredite	
	5	BIO 163	Biologji Qelizore	8 kredite	
	6	BIO 161	Zoologji Intervertebrore	8 kredite	
	7	BIO 160	Botanike e Pergjithshme	8 kredite	
	8	BIO 262	Histologji	7 kredite	
	9	BIO 261	Zoologji Vertebrore	8 kredite	
	10	BIO 375	Anatomi e Krahësuar	6 kredite	
Disiplina te formimit karakterizues te programit (105 kredite)	11	BIO 260	Sistematike e Bimeve	9 kredite	
	11	BIO 264	Mikrobiologji	7 kredite	
	12	BIO 312	Gjenetike	8 kredite	
	12	BIO 367	Bioteknologji	8 kredite	
	13	BIO 364	Fiziologji Bimore	8 kredite	
	14	BIO 365	Fiziologji Shtazore	8 kredite	
	15	BIO 361	Bazat e Ekologjise	8 kredite	
	15	BIO 378	Etologji	4 kredite	
	16	BIO 232	Biokimi	8 kredite	
	17	BIO 241	Anatomi e Njeriut	7 kredite	
Disiplina formuese dhe integruese (15 kredite)		ENGT 131	Anglisht 1		
		ENGT 132	Anglisht 2		
	18	FRET 131	Frëngjisht 1	6 kredite	
		GERT 131	Gjermanisht 1		
		GERT 132	Gjermanisht 2		
		ITAT 131	Italisht 1		
	19	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi		6 kredite	
	Lende me zgjedhje				
	Disiplina formuese të zgjedhura nga studentë (10 kredite)	20	BIO 271	Fitogjeografi	6 kredite
21		BIO 270	Paleontologji dhe Bazat e Gjeologjise	4 kredite	
		BIO 350	Teori e Evolucionit		
		BIO 370	Hidrobiologji		
Pergatitja e Tezes se Diplomes (6 Kredite)	22	BIO 398	Teze Diplome	6 kredite	



Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skele

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

Neni 10.

Ngarkesa mësimore në orë sipas formave të mësimdhënies

Me vendim të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Teknike – UV ndarja e orëve mësimore për një kredit, në orë që zhvillohen në auditor dhe orë studimi për programin mësimor Bcs në Biologji, në bazë të Udhëzimit nr.15 të MASH (kreu VII, pika 6), është zgjedhur si më poshtë:

Ndarja e orëve mësimore për një kredit		
1 kredit leksion	10 orë në auditor	15 orë studim individual
1 kredit ushtrime	12 orë në auditor	13 orë studim individual
1 kredit seminare	8 orë në auditor	17 orë studim individual
1 kredit laborator	18 orë në auditor	7 orë studim individual
1 kredit projekt kursi	2 orë në auditor	23 orë studim individual
1 kredit praktikë mësimore / profesionale	20 orë në auditor	5 orë studim individual

Neni 11.

Plani mësimor i programit Bachelor në Biologji për të tre vitet e studimit:

Programi i studimit Bachelor në Biologji zhvillohet me kohë të plotë. Zgjat tre vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe lëndët zhvillohen sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të parë e të dytë zhvillohen gjithashtu dhe praktika mësimore në terren përkatësisht lëndët: Zoologji Invertebratore dhe Botanikë e Përgjithshme në semestrin e dytë të vitit të parë dhe lëndët: Zoologji Vertebratore dhe Sistematikë e Bimëve në semestrin e dytë të vitit të parë. Në fund të vitit të tretë të studimeve realizohet provimi i diplomës ose mbrojtja e diplomës.

Viti	Semestri	Kodi	Lënda	Kredit	Tot. orë / semestër Brenda & jasht auditorit	Tot. orë / semestër në auditorit	Totali orë / javë në auditorit			Totali orë jashtë auditorit
							lex	Sem / Lab	Prak.	
Viti I	Sem. I	MAT 154	Kalkulus 1	8	200	75	3	2	0	125
		FIZ 161	Fizike	8	200	75	3	2	0	125
		KHM 143	Kimi e Përgjithshme	8	200	75	3	2	0	125
		BIO 163	Biologji Qelizore	8	200	75	3	1/1	0	125
		TOTALI		32	800	300	12	7/1	0	500
Viti II	Sem. II	BIO 161	Zoologji Invertebratore	8	200	95	3	1/1	1 javë	105
		BIO 160	Botanikë e Përgjithshme	8	200	95	3	1/1	1 javë	105
		ENGT 131/PRET 131 GERT 131/ITAT 131/ENGT 132/GERT 132	Anglisht 1/Frëngjisht 1/ Gjermanisht 1/ Italisht 1/ Anglisht 2/ Gjermanisht 2	6	150	75	3	2	0	75
		TOTALI		22	550	265	9	3/1	2 javë	285

Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skë

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

CST 130		Tecnologji Informacioni dhe Komunikimi									
TOTALI											
		28									
		700									
		340									
		11									
		6/2									
		2 jave									
		360									

Viti 2		Tecnologji Informacioni dhe Komunikimi									
Sem. I		BIO 241	Anatomi e Njeriut	7	175	75	3	2	0	100	
		BIO 232	Biokimi	8	200	75	3	2	0	125	
		BIO 262	Histologji	7	175	75	3	1/1	0	100	
		KIM 255	Kimi Organike	8	200	75	3	2	0	125	
		TOTALI		30	750	300	12	8	0	450	
Sem. II		BIO 260	Sistematike e Bimeve	9	225	95	3	1/1	1 jave	130	
		BIO 261	Modul 1: Zoologji Vertebratore	8	200	95	3	1/1	1 jave	105	
		BIO 270/ BIO 271	Palcontologji dhe Bazat e Gjeologjise / Fitogeografi	6	150	60	3	1	0	90	
		BIO 264	Mikrobiologji	7	175	75	3	1/1	0	100	
		TOTALI		30	750	325	12	4/3	2 jave	425	

Viti 3		Tecnologji Informacioni dhe Komunikimi									
Sem. I		BIO 361	Modul 2: Bazat e Ekologjise	8	200	75	3	1/1	0	125	
		BIO 350/ BIO 370	Teori e Evolucionit/ Hidrobiologji	4	100	45	2	1	0	55	
		BIO 364	Fiziologji Bimore	8	200	75	3	1/1	0	125	
		BIO 367	Modul 3: Bioteknologji	8	200	75	3	2	0	125	
		BIO 375	Modul 1: Anatomi e Krahasuar	6	150	60	2	1/1	0	90	
		TOTALI		34	850	330	13	6/3	0	520	
		BIO 312	Modul 3: Gjenetike	8	200	75	3	2	0	125	
		BIO 378	Modul 2: Etologji	4	100	45	2	1	0	55	
		BIO 365	Fiziologji Shtazore	8	200	75	3	1/1	0	125	
		BIO 398	Teze Diplome	6	150	0	0	0	0	150	
				26	650	195	8	4/1	0	455	

Neni 12.
Përshkrimi i lëndëve

Nr.		Kodi	Lënda dhe Përshkrimi	Kredite
1	BIO 160	Botanikë e Përgjithshme	Lënda e Botanikës së Përgjithshme siguron një formim të përgjithshëm të fushës studimore të Botanikës. Në këtë lëndë do të bëhet një hyrje e shkurtër për bimët, jetën, përberjen kimike të bimës, qelizat eukariote dhe ato prokariote. Më pas do të trajtohen ndërtimi i qelizës bimë dhe i trupit bimor duke filluar nga indet dhe organet vegetative rrënja, kërcelli dhe gjetet. Gjithashtu do të jepet njohuri bazë për riprodhimin e bimëve, duke u ndalur më gjatë në	8

Adresa /Address: L. Pavarësin,
Bulevardi Vlorë-Skele

Web-site: www.univbora.edu.al
e-mail: info@univbora.edu.al

			ndërtimin dhe funksionin e organeve riprodhuese të angiospermeve. Trajtimi i qështjeve botanike në nivelin qelizor gërshetohet hera-herës edhe me të dhëna makroskopike të karakterit ekologjik dhe mjedisor, të cilat synojnë shpjegimin, parandalimin dhe rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për ruajtjen, ripërtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore. Programi do të mbyllet me njohuri bazë në fushën e biologjisë së zhvillimit dhe në fushën e Bioteknologjisë Bimore. Zoologji Invertebratore Lënda e Zoologjisë invertebratore synon tu japë studentëve të degës së Biologjisë të vilit të parë njohuri bazë mbi: Ndryshueshmëria në botën e kafshëve. Klasifikimi i invertebratëve. Protozoarët (flagjelatët, amebat, protozoarët spor formues, Ciliofora). Sfungjerët dhe plakozoarët. Struktura e sfungjerëve, fiziologjia, riprodhimi. Knidarët dhe ktenoforët. Lëvizja, ushqimi, shkëmbimi i gazeve dhe jashtëqitja. Sistemi nervor dhe riprodhues. Klasifikimi dhe evolucioni. Rifet koraline. Ktenoforët. Kafshët me simetri bilaterale. Plantelmilët, regjenerimi, riprodhimi. Parazitizmi. Klasifikimi i platelmintëve dhe origjina. Tipi i Nemertinëve. Tipi i nematodëve dhe tipa të tjerë të pseudocclomatëve. Molusqet: karakteristikat morfologjike, fiziologjia, riprodhimi, klasifikimi, filogjeneza dhe evolucioni. Krimbat unazorë: morfologjia, anatomia, fiziologjia, riprodhimi, klasifikimi, origjina dhe evolucioni. Këmbënyjtuarit: morfologjia, anatomia, fiziologjia, klasifikimi, origjina dhe evolucioni. Keliceratët, Krustacetët: morfologjia, anatomia, fiziologjia, klasifikimi, origjina dhe evolucioni. Miriapodët: kilopodet, diplopodet, simfilët. Insektet: suksesi evolutiv, morfologjia, anatomia, fiziologjia, riprodhimi, klasifikimi, origjina dhe evolucioni. Lëkurëgjemborët: morfologjia, anatomia, fiziologjia, klasifikimi, origjina dhe evolucioni. Biologji Qelizore Lënda e Biologjisë Qelizore synon tu japë studentëve njohuri bazë mbi organizimin morfologjik dhe funksional të qelizave prokariote dhe eukariote, ndërtimin dhe funksionin e membranës qelizore, sistemit të brendshëm membranor (trjeji endoplazmatik dhe aparati Golxhi), citoskeletit dhe organele qelizore si bërthama, mitokondritë, kloroplastet, ribozomet dhe lizozomet. Një vështrim i përgjithshëm do ti drejtohet gjithashtu energjitikës qelizore, në veçanti proceseve të frymëkëmbimit qelizor dhe fotosintezës. Do të shqyrtohen proceset e replikimit dhe transkriptimit të mbartësve dhe transmetuesve të informacionit gjenetik (ADN), sintezës së proteinave si dhe mekanizmat bazë të kontrollit të shprehjes së gjeneve. Së fundi do të trajtohen aspektet kryesore që karakterizojnë procese me rëndësi të veçantë si sinjalizimi brendaqelizor, cikli qelizor dhe mekanika e ndarjes qelizore. Biokimi Biokimia është shkencë që studion proceset kimike në organizmat e gjallë. Lënda e Biokimisë synon t'ju japë studentëve të degës së Biologjisë njohuri bazë mbi përbërjen kimike të materies së gjallë, ujin dhe përbërësit mineral të organizmit të njeriut, rolin e ujit në shpërbashkimin elektrolitik, kuptimin mbi përbashin dhe sistemet tamponë të gjakut. Një vështrim i përgjithshëm do ti drejtohet gjithashtu ndërtimit, klasifikimit dhe funksioneve të molekulave biologjike si proteinat, sheqernat, lipidet, vitaminat, enzimat dhe acideve nukleike dhe	8
Lende Baze	2	BIO 161		
	3	BIO 163		
		BIO 232		



			biomolekulave të tjera që ndërtojnë organizmat e gjallë. Në vazhdimësi Biokimia studion proceset metabolike të lëndëve dhe analizimin e bilancit energjiek në organizmin e njeriut gjatë proceseve katabolitike dhe ato anabolitike. Së fundi do të trajtohen aspektet kryesore që karakterizojnë proceset e dyfishimit të materialit gjenetik, të transkriptimit dhe të translatimit. Njëkohësisht do të jepen dhe informacione bazë për të dhënat biokimike të gjakut dhe përbërësve të tij, hormoneve dhe klasifikimin e tyre.	
Lëndë Bazë			Anatomia e Njeriut Programi i lëndës Anatomie e Njeriut synon njohjen e studentëve të kësaj dege me njohuritë mbi trupin e njeriut, anatominë e sistemeve dhe të aparateve, dhe funksionimin e tyre si një e tërë. Gjithashtu ky program synon dhënien e njohurive mbi higjienën e këtyre organeve dhe të sistemit të organeve. Në këtë lëndë studiohen: objekti i anatomisë, Organizmi i trupit të njeriut. Qeliza, indet. Sistemet dhe aparatet. Osteologjia. Ndërtimi dhe klasifikimi i kockave të skeletit. Miologjia. Ndërtimi dhe funksionet e muskujve. Klasifikimi i muskujve të skeletit. Sistemi digestiv. Sistemi respirator, Sistemi urogenital. Veshkat funksioni dhe organet e tjera të ekskretimit. Organet e riprodhimit. Sistemi kardiovaskular. Ndërtimi i zemrës. Sistemi limfatik. Sistemi nervor. Organet e shqisave. Gjëndrat me sekrecion të brëndshëm.	7
	5	BIO 241	Sistematike e Bimëve Sistematika e bimëve trajton lidhjet filogjenetike, përshkrimin, emërtimin, klasifikimin, origjinën dhe evolucionin e grupeve të organizmave, duke filluar me: bakteret (Bacteriophyta), algat (Phycophyta), kërpudhat (Mycophyta), likenet (Likenophyta), myshqet (Briophyta), fieret (Pteridophyta) dhe binët me farë të zhveshur e të veshur (Gymnospermae dhe Angiospermae). Klasifikimi i organizmave, sipas lidhjeve filogjenetike, trajtohet i ndarë në tri domene kryesore: Baktere, Arke dhe Eukariote. Përfaqësuesit për studimin e grupeve të ndryshme bimore, janë marrë nga flora e vendit tonë, të cilët paraqesin një interes të vecantë përsa i përket evolucionit të grupeve bimore dhe përdorimit të tyre praktik. Në përfundim të këtij kursi leksioneve, synohet të fitohet një tablo e qartë e evolucionit të botës bimore, të njihen llojet më të përhapura, si dhe të krijohet një mendim i përgjithshëm dhe i qartë për shumëllojshmërinë, ekologjinë, biologjinë, përhapjen gjeografike dhe natyrën e nje pjese të madhe të florës mjekësore spontane dhe asaj të kultivuar.	9
	6	BIO 260	Histologji Përmes këtij programi synohet pajisja e studentëve me njohuritë bazë mbi metodat dhe objektin e lëndës së histologjisë, organizimin struktural dhe funksional të kater indeve kryesore (epitelial, lidhor, muskular dhe nervor). Studentët do të njihen me arkitekturën tipike të indeve në organet dhe sistemet kryesore të organizmit duke u ndalur edhe në analizimin e funksioneve më të rëndësishme të diferencimit qelizor (sekretimi gjëndror, tejçimi i impulsit nervor etj). Do të trajtohen në mënyrë të detajuar sistemet nervor, i çarkullimit të gjakut, imun, endokrin, tretës, i frymëshkëmbimit, urinar dhe sistemet e riprodhimit të mashkullit dhe të femrës, organet shqisore si syri, veshi etj.	7
	8	BIO 264	Mikrobiologji Mikrobiologjia është një nga disiplinat themelore të biologjisë, e cila gjen aplikim në mjekësi, bujqësi dhe industri. Kjo lëndë ju ofron studentëve një informacion të pasur dhe të thelluar	7



		për çështje të mikrobiologjisë së përgjithshme dhe të aplikuar. Gjatë këtij cikli leksionesh do të trajtohen problematika të tilla si: Biologjia e Mikroorganizmave, Klasifikimi i Mikroorganizmave, dhe Mikrobiologjia e Mjedisit dhe Biomjekësore. Në pjesën e parë trajtohen probleme të biologjisë së qelizës, duke u fokusuar më tepër në veçoritë e qelizës prokariote, metabolizmi mikrobik dhe diversiteti i tij, rritja mikrobike dhe kontrolli i saj, si dhe gjenetika e mikroorganizmave. Në pjesën e dytë do të përshkruhet klasifikimi i mikroorganizmave, karakteristikat dhe bashkëveprimi i tyre me njeriun, kafshët, bimët apo mjedisin. Pjesa e tretë do të trajtojë mikroorganizmat si një komunitet mikrobik i aftë të kolonizojë dhe të modifikojë mjedisin që e rrethon.	8
	BIO 312	Gjenetike Lënda e Gjenetikës jep një formim të përgjithshëm të fushës studimore të Gjenetikës. Gjatë kësaj lënde do të bëhet një hyrje e shkurtër për historinë e gjenetikës dhe do të trajtohen tre fushat e gjenetikës: gjenetika Mendeliane, gjenetika molekulare dhe gjenetika e popullatave. Do të trajtohen shmanget nga ligjet e Mendelit, veçoritë e kromozomeve dhe mutacionet që mund të pësojnë. Temat që do të trajtohen më tej kanë të bëjnë me njohjen e elementëve të trashëgimisë, ligjet e trashëgimisë, ndarjen qelizore dhe teoria kromozomike e trashëgimisë, lidhja e gjeneve dhe ndërtimi i hartave gjenetike të cukariotët, mutacionet gjenike dhe riparimi i tyre, mutacionet kromozomike, ADN-materiali gjenetik, struktura, dyfishimi, kodi gjenetik, struktura dhe funksioni i kromozomeve të eukariotët, kontrolli i shprehjes gjenike, gjenetika e zhvillimit, rregullimi gjenik dhe diferencimi i tij. Në temat e fundit do të trajtohet gjenetika e popullatave dhe teknikat e përdorura në gjenetikën molekulare.	
9	BIO 367	Bioteknologji Bioteknologjia përkufizohet si aplikimi i parimeve shkencore dhe inxhinjerie për shndërrimin e lëndëve nën veprimin e organizmave të gjallë për qëllime praktike. Bioteknologjia synon t'ju japë studentëve njohuri bazë për mikroorganizmat më të përdorshëm në zhvillimin e proceseve bioteknologjike, në studimin e dinamikës së rritjes mikrobike, analizimin e kulturave të qelizave bimore dhe shtazore dhe studimin e teknikave bioteknologjike klasike dhe molekulare. Një vështrim i përgjithshëm do të drejtohet gjithashtu teknologjisë së AND-së rikombinante, teknikave molekulare të kërimit dhe sekuençimit të AND-së si teknika e Maxam-Gilbert dhe ajo e Sangerit, antitirupave mono/poli-klonale dhe metodat e fitimit të bimëve dhe kafshëve transgjenike. Së fundi do të trajtohen aspektet kryesore që karakterizojnë bioteknologjinë humane, diagnostikimin molekular dhe atë imunologjik duke përfshirë teknikën specifike të ELISA. Studimi i vaksinave si agjentë terapeutikë, izolimi i gjeneve humane, terapia gjenike ex-vivo, terapia gjenike in-vivo, terapia gjenike antisense dhe inxhinjria gjenetike në bimë dhe në kafshë.	8
	BIO 361	Bazat e Ekologjisë Studentët në lëndën Bazat e Ekologjisë do të marrin njohuri mbi: Metodën e studimit në ekologji. Faktorët ekologjikë. Faktorët klimatikë. Roli ekologjik i temperaturës. Lagështia. Roli ekologjik i dritës. Faktorët ekologjikë dytësorë. Faktorët edafikë. Ushqimi si faktor ekologjik. Faktorët demografikë.	8



		Faktorët biotikë brendallojëre dhe ndërlojëre. Ndryshueshmëria natyrore dhe stabiliteti i popullatave. Ekosistemet dhe biocenozat. Fluksi i energjisë dhe qarkullimi i lëndëve në ekosisteme. Organizmi i biosferës. Roli i njeriut në biosferë.	
	BIO 378	Etologji Studentët në lëndën e Etologjisë do të marrin njohuri mbi: Sjelljet dhe interpretimet e ndryshme për sjelljet; tipet e sjelljeve, bazat fiziologjike dhe gjenetike të sjelljeve, sjelljet sociale, riprodhuese dhe prindërore tek gjallesat shtazore; inteligjencia, organizimi i sjelljeve të gjallesat shtazore dhe vecanerisht tek primatet.	4
11	BIO 364	Fiziologji Bimore Fiziologjia bimore merret me funksionimin e proceseve në bimë. Objekti kryesor i saj është studimi i proceseve jetësore, njohja dhe shpjegimi i mekanizmave të tyre. Fiziologjia është shkencë e proceseve të rregullimit dhe të kontrollit. Ajo është një shkencë sasore e caktuar. Ajo synon drejt percaktimit të nderveprimeve dhe funksioneve sasore duke përkthyer saktësisht sjelljen e individëve ose llojeve. Objekti i fiziologjisë janë gjallesat, të cilat, si rrjedhojë e historisë së tyre shfaqen me ndryshueshmëri të madhe dhe shumë më të ndërlukuara se sistemet jo të gjalla. Duke u nisur nga larmia, shkalla e ndërlikimit do të trajtohen procese jetësore si: regjimi ujqor, qeliza bimore si sistem osmotik, transpirimi, ngjitja në ksileme, kohezioni, ushqimi mineral, transporti në floemë, fotosinteza, frymëmarrja, fotofrymëmarrja, metabolizmi i azotit dhe squfurit, metabolizmi i lëndëve dytësore. Po ashtu, rritja dhe zhvillimi, hormonet bimore, lëvizjet e bimëve, fotomorfogjeneza, ritmet biologjike, fotoperiodizmi, reagimi i bimëve ndaj temperaturës si dhe fiziologjia e stresve bimore. Bimët nuk janë pa jetë, si të japin përshtypjen në pamje të parë. Në brendësi të tyre ndodhin procese fiziologjike të panumërta. Njëpërmjet rrugëve të specializuara levizin uji dhe lëndët e tretura në të: uji nga toka nëpërmjet rrënjëve, kërcëjtje dhe gjetheve në atmosferë, si dhe kripërat minerale dhe molekulat organike në shumë drejtime në brendësi të trupit të bimës. Në çdo qelizë të gjallë kryhen mijëra reaksionesh kimike. Qëllimi i fiziologjisë është të njohë mënyrat e rregullimit dhe të kontrollit të proceseve fiziologjike, vlerësimin sasior të tyre si dhe përcaktimin e rregullsive për çdo proces dhe formë jetësore të vecantë.	8
	BIO 365	Fiziologji Shtazore Fiziologjia e gjallesave shtazore është një shkencë eksperimentale e cila synon t'ju japë studentëve njohuri bazë për organizmat e gjallë shtazorë. Në pjesën e parë lënda e Fiziologjisë shtazore analizon proceset e homeostazës, ndërtimin e qelizave nervore, biokimikë dhe mekanikë të kurrizës muskulare dhe anatominë fiziologjike të sistemit nervor, duke specifikuar funksionet lëvizore dhe funksionet ndjesore të sistemit nervor. Më pas në pjesën e dytë lënda e Fiziologjisë shtazore studion në mënyrë të hollësishme organet shqisore si nga ana anatomike dhe nga ajo funksionale, organin e të parit, sistemin e të dëguarit dhe ndjeshmërinë kimike, të shijuarit dhe të nuhaturit. Analizon konceptet bazë të përgjithshme të endokrinologjisë duke u fokusuar në mekanizmin e veprimit të hormoneve, të sistemit hipotalamo-hipofizar, të gjendrës tiroide dhe të gjendrës së pankreasit. Në pjesën e tretë përfundimtare lënda e Fiziologjisë shtazore i përmbledh lëksionet në studimin e organeve gjinitale femërore dhe ato mashkullore, në analizimin e aparatit të qarkullimit të gjakut, të	8



		sistemit të frymëkëmbimit dhe të proceseve të tretjes dhe përthithjes.	
	BIO 261	Zoologji Vertebrorë Zoologjia e vertebrorëve trajton elemente anatomik të ndërtimit të trupit të cilat janë të domosdoshëm në traktimin e evolucionit të vertebrorëve. Për secilën klasë janë paraqitur elemente të vecantë të saj, jo vetëm të karakterit anatomik por edhe fiziologjik, etologjik dhe ekologjik. Në këtë lëndë merren në studim: Kordatët, vetitë, origjina. Cefalokordatët. Amfibi. Vertebratët. Agnatët: anatomia dhe sitematika. Peshqit: anatomia, sistematika. Amfibët: karakteristikat, veçoritë, sistematika. Reptilët: veçoritë, evolucioni. Sistematika. Shpendët: veçoritë, sistematika. Gëlltarët: veçoritë, prejardhja, sistematika.	8
13	BIO 375	Anatomi e Krahësuar Anatomia e krahësuar trajton sistemet anatomike të trupit të Vertebrorëve, në ecurinë evolutive të tyre, bazuar në homologjinë, nga një klasë në tjetrën. Në këtë lëndë analizohen me rradhë, në mënyrë të krahësuar (tek peshqit, amfibët, reptilët, shpendët, gëlltarët) të gjitha sistemet dhe aparatet e trupit të vertebrorëve. Analizimi dhe krahasimi fillon me skeletin e vazhdon me sistemin muskular, aparatit tretës, aparatit të frymëmarrjes, aparatit e qarkullimit të gjakut, aparatit urogenital, sistemin nervor, organet e shqisave si dhe organet endokrine. Kjo mënyrë trajtimi e sistemeve anatomike të ndërtimit të trupit të vertebrorëve, lehtëson përvehtësimin e lëndës nga ana e studentëve, mbasi sistemet trajtohen në dinamikën e tyre duke bërë që të mësuarit logjik të mbizotërojë ndaj atij me memorjë.	6
14	CST 130	Teknologji Informatikoni dhe Komunikimi Temat e trajtuara në lëndën Teknologji Informatikoni dhe Komunikimi siguron një formim të përgjithshëm për bazat e informatikës. Në temat e trajtuara theksohet rëndësia e kompjuterit dhe informatikës në aspektin ekonomik. Studimi i pjesëve kompjuterike, i programeve baze të paketes Microsoft Office, sistemet numerike, interneti dhe hyrje në algoritme dhe programim në gjuhën C, shërben për të njohur në vija të përgjithshme bazat e teknologjise së informacionit dhe komunikimit.	6
15	FIZ 151	Fizikë Per studentet e shkencave dhe te inxhinierise. Temat perfshijne studimin e mekanikes klasike dhe termodinamikes: idete njutoniane te hapësirës, kohës dhe lëvizjes, ligjet e ruajtjes, lëkundjet dhe valet, fluidet, teoria kinetike e gazeve dhe parimet e termodinamikes. Ky kurs synon pervetesimin e koncepteve dhe parimeve baze dhe aftesimin e studenteve ne zgjidhjen e problemeve; motivimin e studenteve permes shembujve praktikë nga jeta e perditshme qe demonstrojne rolin e fizikes ne disiplinat e tjera si: inxhinierite, matematika, kimia, biologjia, informatika; pajisjen e studenteve me nje kornize konceptuale per ristrukturimin e njohurive te tyre, duke pretenduar kalimin e tyre gradualisht nga niveli i njohjes ne nivelin e studimit te fizikes. <i>Permblush kerkesat e edukimit te pergjithshem universitar per studentet e shkencave dhe inxhinierive.</i>	8
16	KIM 143	Kimi e Përgjithshme Lënda e Kimisë së Përgjithshme synon që tu japë studentëve të Fakultetit të Shkencave Teknike njohuri baze mbi lëndën, elementet dhe substancat kimike. Gjatë leksioneve dhe	8



Adresa /Address: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skele

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

		seminareve behet një rishikim me i avancuar i njohurive të marra në Shkollën e Mesme të Përgjithshme në lenden e Kimisë, kurse për ata studentë që vijnë nga Shkolla të Mesme Profesionale synohet të jepen që në fillim dhe njohuritë bazë të Kimisë së Përgjithshme. Ky program synon të japë një formim të përgjithshëm për të interpretuar fenomenet kimike dhe për të thelluar njohuritë me karakter kimik që mund t'u paraqiten gjatë viteve të studimit dhe në aktivitetin e tyre profesional. Në program janë përfshirë: Historiku i Kimisë si shkencë. Teoria atomike e Daltonit. Formulatat kimike. Nxjerja e formulave kimike. Stokiometria. Ndërtimi i atomit. Lidhja jonike. Lidhja kovalente. Strukturat e Leësis. Gjeometria e molekulave. Gazet. Lëngjet dhe trupat e ngurtë. Tretësirat. Reaksionet në tretësira ujore. Ekuilibri kimik. Termodinamika. Elektrokimika. Metalet. Kimia Bërthamore.	
17	KIM 255	Kimia Organike Lënda "Kimia Organike I" ka për qëllim njohjen e studentit me lidhjet kimike, hibridizimet, përbërjet e ndryshme organike, si hidrokarburet alifatike dhe aromatike, stereokiminë e komponimeve të karbonit, halogjenuret organike, etj., Në mënyrë të përgjithshme, në programin e Kimisë Organike do të përfshihen leksione e seminare në lidhje me: Hibritizimet që shfaqen atomi i karbonit në komponimet organike, lidhjet kimike, orbitalet atomike e molekulare, koncepte të ndryshme mbi acidet dhe bazat, efekti induktiv e mezon, izomeria optike si dhe llojet kryesore të reaksioneve dhe përdorimet kryesore të tyre në kiminë organike. Njohuri të përgjithshme për komponimet organike, klasifikimin, emërtimin përfundim dhe vetitë e këtyre klasave të komponimeve organike. Ndër klasat kryesore të komponimeve organike që do të trajtohen gjatë këtij cikli leksionesh e seminaresh, përmendim: alkalet dhe cikloalkanet, alkenet, alkinet, halogjenurët e alkilit, komponimet aromatike, benzeni dhe homologet e tij, alkoolet, si dhe përcaktimi i strukturës së komponimeve të ndryshme nëpërmjet metodave të ndryshme instrumentale etj. si: spektrometria e masës, spektroskopia IR, NMR dhe UV (për komponimet e konjuguar). Krahas leksioneve janë parashikuar rreth 30 seminare në lidhje me temat që do të zhvillohen në leksione, gjatë të cilëve, do të bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve të studentëve nëpërmjet detyrave të shërbisë dhe atyre që do të zhvillohen në klasë si dhe do të diskutohet rreth çështjeve për të cilat studentët mund të kenë paqartësi.	8
18	MAT 154	Kalkulus 1 Konceptet e funksionit, derivatit, rregullat e derivueshmerise, integrimi, llogaritja e sipërfaqeve dhe vëllimeve, simetria, ekstremumet, monotoninë dhe duke vazhduar më tej me limitin e funksionit, vazhdueshmerine e tij, diferencimin dhe integrimin e funksioneve me një variabël, aplikime të ndryshme të kalkulusit në inzhinieri, ekonomi, finance, shkenca shoqërore, etj. Plotëson kërkesat e të gjitha programeve për një formim të përgjithshëm.	8
19	BIO 270 BIO 271	Paleontologji dhe Bazat e Gjeologjisë Paleontologjia. Origjina e jetës, provat gjeologjike. Sistematika e botes organike dhe provat e jetës. Prije evolutive e botes organike. Bimet fosilet. Gjeologjia. Toka, shikim tokësor dhe planetar. Shkëmbinjte, formimi dhe kalci. Proceset gjeologjike ekzogjene. Proceset gjeologjike endogjene. Fitogjeografi Fitogjeografia studion arealin, faktorët që përcaktojnë formën dhe përhapjen e arealeve, përmasat e arealeve, shpërndarja vertikale të elementëve gjeografikë të florës. Kufizim i individ	6

			asociacionit, përshkrimi florik dhe struktura e individ asociacionit, perberja llojore lista e llojeve, pasuria florike, fizionomia e bimëve, format biologjike dhe struktura e bimësisë: katëzimi, sinusialiteti, mozaiciteti. Një vështrim i përgjithshëm do ti drejtohet gjithashtu fizionomisë së bimëve, formave biologjike, dhe struktura të bimësisë: Së fundi do të trajtohen aspektet kryesore që karakterizojnë faktorët klimatikë, faktorët ekologjik: ajri, toka, faktorët kimik, faktorët topografikë, faktorët biotikë dhe antropogjenë, zjaret si faktorë mekanik, zonimi horizontal dhe vertikal i bimësisë, bimësia e pyjeve dhe shkoretave mesdhetare, dushkajat, zona e ahut dhe alpine, zona pyjore dhe shkurre, mbi vlerësimin geobotanik të kullotave dhe të livadheve tona natyrore dhe sintaksonomia. Kategoritë e zonave të mbrojtura, mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e florës dhe bimësisë në vendin tonë.	
		BIO 370	Hidrobiologji Në lëndën e Hidrobiologjisë trajtohen temat e mëposhtme: hyrje në Hidrobiologji, të dhëna të përgjithshme për oqeanet dhe ekosistemin detar, karakteristikat abiotike të mjedisit detar, përbërja e ujit të detit, klasifikimi i mjedisit detar, studimi i planktonit, nektonit, meiofaunës dhe bentosit detar, studimi i prodhimtarisë parësore dhe prodhimtarisë dytësore, ndikimi i njeriut dhe peshkimi detar, mjediset ujore të njelmëta dhe të kripura, karakteristikat abiotike të mjedisve liqenore, prodhimtaria, rrjetat trofike, piramidat ekologjike, popullimet e ujrave liqenore, ndikimi i njeriut mbi ekosistemin liqenor, eutrofikimi.	4
		BIO 350	Teoria e Evolucionit Historia e biologjisë. Lamarku dhe Darvini. Parimet e teorisë së evolucionit. Mikroevolucioni. Struktura gjenetike e popullatave. Faktorët e evolucionit. Speciet. Makroevolucioni. Origjina e jetës. Origjina e njeriut.	
Lënde me Zgjedhje	21	ENGT 131	Anglisht 1 Programi i mëposhtëm është programuar për studentët e Departamentit të Shkencave të Biologjisë, sidomos për studentët në mënyrë që të kenë aftësi shprehëse angleze në jetë dhe në shkollë si mësues të klasave të biologjisë, duke përfshirë këtu edhe njohuri të përgjithshme rreth mjedisit natyror dhe pjesës tjetër të devijimeve natyrore, të eco-sistemeve duke filluar nga trupi ynë, i njeriut deri në pjesën tjetër të fatkeqësive apo shkatërrësive natyrore . Duke u bazuar në disa ngjarje dhe informacione për fenomenet rreth botës, ky libër kombinon një program mësimor të fortë të ciklit të lartë me fjalor për florën dhe faunën dhe aftësitë që studentit duhet të përshtasi me sukses në fushat e tyre specifike. Rëndësi e veçantë iu është kushtuar përshtatjes mbi baza teorike që u lejon atyre të kuptojnë dhe të përgjithësojnë njohuritë angleze të marra deri tani .	6
		ENGT 132	Anglisht 2 Kursi synon të pajisë studentin me njohuritë gjuhësore bazë të nivelit mesatar në gjuhën angleze. Ne këtë kurs do të trajtohen kryesisht çështje gramatikore dhe leksikore si dhe do të punohet me zhvillimin e aftësive lexuese.	
		GERT 131	Gjermanisht 1 Kursi synon të pajisë studentin me njohuritë gjuhësore bazë të nivelit fillestar në gjuhën gjermane. Ne këtë kurs do të trajtohen kryesisht çështje gramatikore dhe leksikore si dhe do të	

		punohet me zhvillimin e aftësive lexuese.
GERT 132		Gjermanisht 2 Kursi synon të pajisë studentin me njohuritë gjuhësore bazë të nivelit mesatar në gjuhën gjermane. Në këtë kurs do të trajtohen kryesisht çështje gramatikore dhe leksikore si dhe do të punohet me zhvillimin e aftësive lexuese.
ITAT 131		Italisht 1 Programi përmban një cikël temash të zgjedhura që e ftojnë studentin të reflektojë dhe të zgjedhë në mënyrë alternative nëpërmjet: sugjerimeve, fakteve apo teksteve interesante për diskutim. Temat e trajtuara në këtë lëndë synojnë: të aftësojë studentin të përdorë gjuhën italiane si mjet për të zgjeruar aftësitë kuptimore dhe shprehëse. të krijojë diskutim në përputhje me programin, nivelin, interesat dhe përvojat personale. të shprehë qendrimet e pikëpamje për probleme të ndryshme shoqërore dhe historike. të perfeksionojë të kuptuarit e njohurive lidhur me procesin, metodën gjuhësore dhe tematikën e vendosur si edhe të kompozojë e përshtasë informacione të ndryshme të marra prej mediave apo temave të parashtruara nga lektori.
FRET 131		Frëngjisht 1 Kursi synon të pajisë studentin me njohuritë gjuhësore bazë të nivelit fillestar në gjuhën frënge. Në këtë kurs do të trajtohen kryesisht çështje gramatikore dhe leksikore si dhe do të punohet me zhvillimin e aftësive lexuese.
Diploma	22	Teze Diplome Diplome. Një projekt individual që ka për qëllim të sintetizojë njohuritë dhe aftësitë e fituara në kurrikulen perkatese. Kërket raportim me shkrim dhe prezantim me gojë.
		6

Neni 13

Gjuha në të cilën zhvillohet program i studimit Bachelor në Biologji është: Gjuha Shqipe.

Neni 14

Afati i studimeve për çdo cikël studimesh është i përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Studenti mund të përfundojë studimet e plota, brenda afatit të rregullt të studimeve ose tej kufirit që parashikon ky afat, por duke iu nënshtruar detyrimeve që lindin nga kohëzgjatja e studimeve përtej kohës normale.

Neni 15

Orari i studimit dhe provimeve

Adresa /Address: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skëllë

Web-site: www.univlori.edu.al
e-mail: info@univlori.edu.al

Leksionet do të zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FSHT. Orari shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit në websitin e universitetit dhe ambientet e fakultetit. Orari bëhet nga Departamenti i Biologjisë dhe miratohet nga zëvendës-dekani i FSHT-së dhe zëvendës-rektori akademik i UV.

Orari është i detajuar dhe përcakton auditorin, kohën dhe zhvillimit të mësimi si dhe pedagogët mësimdhënës dhe mund të ndryshojë vetëm me miratimin e zëvendës-vektorit akademik ose rektorit të UV. Orari mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementëve të mësimi dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Kjo ngarkesë luhet nga 20-25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 50 minuta.

Neni 16

Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese:

Me vendim të Këshillit të Fakultetit të Shkencave Teknikë – UV duke nisur nga viti akademik 2011 - 2012 e në vazhdim kreditet penguese për marrjen e moduleve të programit Bio në Biologji do të jenë si më poshtë:

Studenti që ndjek programin mësimor Bcs në Biologji		
- mund të rregjistrohet në lëndët me kode Bio 2	vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 30 ECTS në këtë program studimi.	
- mund të rregjistrohet në lëndët me kode Bio 3	vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 90 ECTS në këtë program studimi.	

Neni 17

Kurrikulat e ofruara studentëve.

Kurrikulat e moduleve të ofruara për studentët nga Departamenti i Biologjisë janë paraqitur në syllabysset përkatëse të çdo lënde, dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.

Programi i plotë i kurrikulave mësimore të ofruara për studentët e Departamentit të Biologjisë për programin Bcs në Biologji mund të tërhiqet tek Zyra e Rregjistrimit të UV, pas pagesës përkatëse.

Neni 18

Format dhe organizimi i studimit të programit Bcs në Biologji

Në programin mësimor Bcs në Biologji veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në: mësim në auditor (leksione, ushtrime, seminare, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, pregatitje provimesh, pregatitje e tezës së diplomës etj.). (kreu VIII, pika 1, udhëzimi nr.15 i MASH)

Leksionet, seminarat dhe laboratorët zhvillohen në ambientet e Universitetit 'Ismael Qemali' Vlorë.

Grupet mësimore të këtij programi organizohen si më poshtë: (kreu X, pika 1,2, udhëzimi nr.15 i MASH)

Grup mësimor për leksione: 80-100 studentë.

Grup mësimor për seminare, praktika mësimore apo profesionale: 25-50 studentë.

Grup mësimor për laboratore apo mësim praktikë: 10-20 studentë.

Neni 19

Format e provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët.

Programi mësimor Bes në Biologji parashikon në total 22 vlerësime përfundimtare të dijeve, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare të lëndëve mësimore, dhe tezës së diplomës. (kreu VIII, pika 7, udhëzimi nr.15 i MASH).

Për modulet e koordinuara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjial i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit.

Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, provimet e formimit, temat e diplomave.

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provim i pjesëshëm, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final). (kreu II, pika 5, udhëzimi nr.15 i MASH)

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

a) me shkrim,

b) me gojë,

c) i kombinuar, me shkrim e me gojë duke u mbështetur në programin mësimor.

Sipas rregullores së UV, kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi të pjesëshëm, një provimi final gjithë përfshirës si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final.

Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyrë në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës, për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në note etj, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs. Pesha (përqindja) e provimit të pjesëshëm, të jetë nga 25-30% e vlerësimit të përgjithshëm dhe zhvillohet jo më larg se java e shtatë, ndërsa 10-15% e vlerësimit të përgjithshëm, mund të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, të gjitha së bashku.

Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Në përfundim të programit të studimit studentit i njehsohet Nota Mesatare e Ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese. (kreu VII, pika 7, udhëzimi nr.15 i MASH)

Neni 20

Kushtet për tu konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ..., 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese. Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabys, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ujia e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të Departamentit të Biologjisë.

Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjial i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studentit duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 21

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve:

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Në bazë të rregullores së UV, kontrolli i njohurive në programet mësimore të FSHT bëhet me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit apo skedave të vlerësimit në laboratore dhe praktika mësimore.
2. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi Ad Hoc për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim Përgjegjësit të Departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin.

Neni 22

Studentët kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si

dhe në datat e përcaktura nga dekani i fakultetit para mbrojtjes së diplomës, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë.

Neni 23

Masa e frekuentimit

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe praktikave në terren përcaktohet në rregulloren e UV-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FSHT. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%. Numri i mungesave të lejuara përlllogaritet për gjithë semestrin përkundëjt numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që i takojnë provimeve të pjesshme. Çdo pedagog pajiset me regjistrin përkatës i cili përmban informacion mbi veprimtarinë e mësimdhënies dhe frekuentimit. Pedagogu përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin.

Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet për shkak të mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në provimin e pjesshëm duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 80%.

Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%.

Frekuentimi i laboratorëve dhe i praktikave në terren është i detyrueshëm në masën 100%. Nëse, për arsye objektive, do të ketë mungesa në orë të veçanta laboratorike, do të gjendet koha e përshtatshme për zëvendësimin e tyre.

Neni 24

Rikontrollimi i dijeve të fituara

Studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet duhet tu nënshtrohen kontrolleve për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara; kontrolle këto për të garantuar mosvjetërimin e dijeve dhe përditësimin e tyre për kreditet e fituara më parë. Edhe studentët që u kanë zgjatur studimet më shumë se tre vjet përtej kohës normale të fitimit të diplomës për Bes në Biologji, para dhënies së tezës së diplomës, u kontrollon kreditet e fituara.

Neni 25

Karakteristikat e Detyrave/Projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit në programin Bes në Biologji janë dy tipesh: (individuale apo në grup).

Neni 26

Karakteristikat e Tezës së Diplomës

Projektet e Tezës së Diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

Të jenë studime deskriptive apo analitike.

Jo domosdoshmërisht origjinale,

Me udhëheqje shkencore .

Neni 27

Modalitetet për dhënien e diplomës në programin Bcs në Biologji

Në përfundim të programit të studimeve, për fitimin e diplomës studenti merr pjesë në provimin e diplomimit, ose parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur në rast kur mesatarja e lëndëve është mbi 9.0. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore. Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një paraqitje të pëmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëheqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë.

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të parë të studimeve në programin Bcs në Biologji në Fakultetin e Shkencave Teknike – UV janë:

1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat: e formimit të përgjithshëm karakterizuese ndërdisiplinore, të lidhura me disiplinat karakterizuese.
2. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në: 2 module të disiplinave me zgjedhje 1 modul për njohuri të tjera formuese (gjuhë e huaj).
3. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në tezën e diplomës, sipas kërkesave të paraqitura në Nenin 17 të Rregullores së këtij programi mësimor.
4. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 180 ECTS (kredite).

Procedura e diplomimit

1. Studenti paraqet në Sekretarinë e Departamentit të Biologjisë, Fakulteti i Shkencave Teknike kërkesën për diplomim, së bashku me gjeneralitetet personale.
2. Në bazë të kërkesës së studentit merret një kopje e listës së notave të studentit nga Zyra e Rregjistrimit të "Universitetit Ismail Qemali"-Vlorë.
3. Komisioni i verifikimit të diplomave verifikon plotësimin e kriterëve të diplomimit për Bachelor Biologji.
4. Nëse pas verifikimit konstatohet se studenti i ka plotësuar kriteret për tu diplomuar, Departamenti i Biologjisë, Fakulteti i Shkencave Teknike paraqet në Rektorat aprovimin e diplomimit të studentit në fjalë.

5. Pasi Rektori i Universitetit "Ismail Qemali"-Vlorë aprovon kërkesën për diplomim Zyra e Rregjistrimit plotëson Diplomën dhe suplementin e Diplomës për çdo student.
6. Studenti merr formularin për marrjen e diplomës tek Zyra e Rregjistrimit dhe paraqitet në Bankë për të bërë pagesën.
7. Pasi bën pagesën, me faturën e bankës tërheq Diplomën tek Zyra e Rregjistrimit.
8. Nëse studentit i nevojitet program merr formularin për program tek Zyra e Rregjistrimit, bën pagesën tek Banka, më pas tërheq programin e firmosur nga Zv.Rektori dhe të vulosur tek Zyra e Rregjistrimit.

Neni 28

Shkeljet e rregullave të fakultetit

Shkelje të rregullave të FSHT konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cënojnë personalitetin e mësimdhënies dhe të çdo punonjësi tjetër të shkollës, normat etiko – morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale.

Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim;
- përjashtim nga shkolla për një vit;
- përjashtim nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës;
- përjashtim përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës.

Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr Dekanati i Fakultetit të Shkencave Teknike.

Vendimin për përjashtimin nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (duke mos i lejuar të litojë të drejta studimi të mëpasëshme) e merr Rektori i Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, mbi bazën e propozimit të Dekanatit.

Neni 29

Shkeljet e integritetit akademik

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Fakultetin e Shkencave Teknike - UV duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integriteti akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është situar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.
2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë

burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perfrazimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perfrazimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kurse ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

3. Mashirim në raporte laboratorie duke falsifikuar të dhëna apo duke dorëzuar të dhëna të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.
4. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.
5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterike duke përfshirë modifikimin e skedar kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përfshirje të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kurse, provime, raporte laboratorie dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim.

Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kurse e bazuar në punë kërkimore, referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëkëzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 30

Kushtet për procedurat e modalitetet për ndërprerjen e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste: Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjeko – ligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi. Dokumentat duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit. Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat e Pushtetit Lokal. Këto dokumenta duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit. Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra rradhë, duhet të aplikojnë përsëri për pranim në Universitet. Vendimi merret nga një komision i ngritur nga Rektorati.

Neni 31

Adresa /Address: L. Pavartësia,
Bulevardi Vlorë-Skellë

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve

Procedurat transferuese në Fakultetin e Shkencave Teknike përcaktohen në rregulloren e Universitetit 'Ismael Qemali' të Vlorës. Procedurat transferuese përfundojnë përpara para fillimit të semestrit.

Neni 32

Rezultatet e frekuentimit, provimeve përfundimare të moduleve dhe të provimit ose mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Departamentit të Biologjisë dhe Sekretarinë Mësimore të FSHT.

Neni 33

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë "Bachelor në Biologji" të firmosur nga Dekani i FSHT dhe nga Rektori i UV dhe suplementin e diplomës.

Neni 34

Dispozita të veçanta

Këshilli i Fakultetit të Shkencave Teknike – UV ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.





Adresa / Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skele

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al